KËRKESË
Nr.2992, datë 24.4.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasurinë që preket nga ndërtimi i një kanali për vendosjen e në tombinoje përgjatë superstradës Lezhë-Shkodër, sesioni Piraj-Kthesa Vau i Dejës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në pronësi të Shtjefën Gjon Zefit me sipërfaqe totale 414 m^2 tokë arë, në shumën totale prej 155 664 (njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

Pronari dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT
DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi